**REPUBLIKA E KOSOVËS**
*Republika Kosova – Republic of Kosovo*

**KOMUNA E MITROVICËS JUGORE**
*Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South*

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **07.08.2025** |
| **REFERENC-Ë:** | 02-052/01-0047239/25 |
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin Komunal**<br>**Kryesuese, Vesa BROJA** |
| **KOPJE :** | **Drejtorëve të Drejtorive** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Zyrës për Komunikim me Publikun** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Blerina Kastrati Idrizi**<br>**Udhëheqëse e Njësisë së Komunikimit me Publikun** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Raport nga Konsultimi Publik - Projekt - Rregullorja për Transparencë dhe Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut** |

Të nderuar,

Duke u bazuar të nenin 12, 58 pika (h), dhe nenit 68, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 23, 48 pika (m) të Statutit të Komunës së Mitrovicës, Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna,

Komuna e Mitrovicës ka organizuar mbajtjen e konsultimit publik për Projekt - Rregulloren për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë në komunën e Mitrovicës se Jugut. Konsultimi Publik i lartcekur është mbajtur me datën 24.07.2025 në ora 14:00 në Sallën e Kuvendit Komunal.

Të pranishëm kanë qenë gjithsej njëzet e gjashtë (26) qytetarë. Ndërsa formularët për komente u janë shpërndarë gjatë konsultimit publik mirëpo nga qytetaret e pranishëm nuk janë parashtruar komente.

*Me respekt !*

*Bashkangjitur mund të gjeni :*
*Raportin dhe listën e pjesëmarrësve*

## RAPORT NGA KONSULTIM PUBLIK

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka organizuar konsultimin publik mbi Projekt - Rregulloren për Transparencë dhe Projekt - Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2025–2029.

Ky konsultim publik është mbajtur me datën 24.07.2025 (e enjte). Informimi paraprak për palët e interesuara është bërë 14 ditë para mbajtjes se takimit.

Lajmërimi për takimin është bërë në kohë dhe në mënyrë të shumëanshme, për të garantuar përfshirjen e sa më shumë qytetarëve. Njoftimi është publikuar:

- në **faqen zyrtare të Komunës** në të dy gjuhët zyrtare,
- në **rrjetet sociale** të Komunës (Facebook),
- në **Platformën Qeveritare për Konsultime Publike**,
- në **hyrje të objektit të Komunës**,
- në **TV Mitrovica**,

https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-Konsultim-Publik-Rregullorja-per-Transparence-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence.pdf

https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/RREGULLORJA-PER-TRANSPARENCE-NE-KOMUNEN-E-MITROVICES-SE-JUGUT-Finale.docx

https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Plani-i-veprimit-per-transparence-ne-Komunen-e-Mitrovices-se-Jugut-2025-2029.docx

https://www.facebook.com/photo?fbid=1141365711358284&set=pcb.1141365514691637

https://konsultimet.rks-gov.net/

Gjithashtu edhe ekzekutivi i komunës në krye me Kryetarin e Komunës janë njoftuar rreth Projekt - Rregullores për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Gjatë këtij takimi, Kryesuesja e Komisionit, Blerina Kastrati Idrizi, ka njoftuar të pranishmit lidhur me përmbajtjet e këtyre dy dokumenteve strategjike, duke thënë se qëllimi i hartimit të kësaj Rregulloreje dhe Planit është rritja dhe forcimi i transparencës në punën e organeve të Komunës

së Mitrovicës, pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal si dhe zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente publike.

**Projekt-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Mitrovicës** përcakton rregullat që sigurojnë transparencën në punën e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit, drejtorive, mekanizmave të tjerë ligjorë, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Paralelisht me hartimin e Rregullores, është hartuar edhe **Projekt-Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025–2029**, ku përmes tij synojmë të kontribuojmë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarët dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse.

Në këtë Projekt - Plan parashihet publikimi i dokumenteve të ndryshme, afati kohor se kur duhet të publikohen, njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumentit dhe mënyra e njoftimit.

Formularët për komente dhe lista e pjesëmarrësve janë shpërndarë gjatë diskutimit publik mirëpo nga qytetarët nuk janë parashtruar komente apo sugjerime.

Në platformën qeveritare të konsultimeve publike, janë dhënë komente nga organizata Demokracia Plus (+), këto komente janë trajtuar nga grupi punues, i cili ka vlerësuar se komentet e dhëna janë jo-relevante dhe në mos përputhje me dispozitat ligjore.

Konsultimi publik me qytetarë përfundoi në orën 15:00 dhe morën pjesë 26 qytetarë, prej tyre 12 femra dhe 14 meshkuj.

| Metodat e Konsultimit | Datat/kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve |
|---|---|---|
| 1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike | 30 ditë | 26 |
| 2. Publikimi në ueb faqe | 14 ditë | 26 |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

## Konsultim Publik – Rregullorja për Transparencë dhe Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal
Data: 24.07.2025
Ora: 14:00

**LISTA E PJESËMARRËSVE**

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Vendbanimi | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Adelina Yenice | Mitrovice | [signature] |
| 2 | Sadije Jashari | Mitrovice | [signature] |
| 3 | Jahir Samiçi | Mitrovicë | [signature] |
| 4 | Blerina Tirizi | Mitrovice | [signature] |
| 5 | Shqipe Halili | Mitrovice | [signature] |
| 6 | Amir Kelmendi | Mitrovic | [signature] |
| 7 | Skënder Ukaj | Mitrovice | [signature] |
| 8 | Liridona Muharremi | Mitrovice | [signature] |
| 9 | Sofije Kushiti Peci | Mitrovicë | [signature] |
| 10 | Shpendi Haxhu | Mitrovice | [signature] |
| 11 | Vlora Hoxhiu | Mitrovicë | [signature] |
| 12 | Fjolla Carani | Mitrovicë | Floro |
| 13 | Musa Hajradini | Mitrovice | [signature] |
| 14 | Shpresa Syla | — // — | [signature] |
| 15 | Edmond Veseli | Mitrovic | [signature] |
| 16 | Egzon Aliu | Kqiq i Madh | [signature] |
| 17 | Zenel Derofi | Mitrovic | [signature] |
| 18 | Dësnik Rexha | Mitrovic | [signature] |
| 19 | Gani Preteni | Mitrovice | [signature] |
| 20 | Xhafadin Halili | Mitrovica | [signature] |
| 21 | Ali Halili | Mitrovicë | [signature] |
| 22 | Sarsenill Halili | Mitrovic | [signature] |
| 23 | Sadete Shabani | Mitrovic | S. Shabani |
| 24 | Bektesh Selmani | — // — | Selmani |
| 25 | Remzi Aliu | Mitrovi | [signature] |
| 26 | Mirvete Istogu | Mitrovic | [signature] |

5 pako letër.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Grupi punues për hartimin e Rregullores për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut**
**Nr. 01-020/04-0027010/25 dt. 11.07.2025**
**Mitrovicë**

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna lëshon këtë:

## NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Rregulloren për Transparencë në Komunën e Mitrovicës dhe Projekt-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029.

Këto dy dokumente do të jenë në konsultim publik nga data 11.07.2025 deri më datën 08.08.2025, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet më datë 24.07.2025, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 14:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më datën 08.08.2025, në email adresën:

✉ blerina.h.kastrati@rks-gov.net

Për më shumë detaje, në lidhje me Projekt -Rregulloren për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Projekt - Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, mund të vizitoni vegëzat e mëposhtme:

- Uebfaqja zyrtare: https://mitroviceejugut.rks-gov.net
- Platforma e Konsultimeve Publike: https://konsultimet.rks-gov.net
- Facebook: https://www.facebook.com/MitroviceJugut

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E MITROVICËS * OPŠTINA MITROVICE-MITROVICA

**Kryetare e Grupit Punues**
**Blerina Kastrati Idrizi**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**SKUPŠTINA OPŠTINE JUŽNA MITROVICA**
**Radna grupa za izradu Pravilnika o Transparentnosti i Akcionog Plana za Opštinsku Transparentnost u Opštini Južna Mitrovica**
**Br. 01-020/04-0027010/25 od 11.07.2025**
**Mitrovica**

Zasnivajući se na Zakon Br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, Statutu Opštine Južna Mitrovica i Administrativnom Uputstvu (MALV) Br.04/2023 o Otvorenoj Upravi u Opštinama, Opština izdaje ovo:

OBAVEŠTENJE O JAVNOJ KONSULTACIJI

U vezi sa organizovanjem javne konsultacije sa građanima o Projekt-Pravilniku o Transparentnosti u Opštini Mitrovica i Projekt-Akcionog Plana za Opštinsku Transparentnost 2025-2029.

Ova dva dokumenta će biti na javnoj konsultaciji od dana 11.07.2025 do dana 08.08.2025, dok će se javna konsultacija sa građanima održati dana 24.07.2025, u Sali za sednice Skupštine Opštine, sa početkom u 14:00 časova.

Komentare i sugestije možete dostaviti do dana 08.08.2025, na e-mail adresu:

✉ blerina.h.kastrati@rks-gov.net

Za više detalja u vezi sa Projekt –Pravilnikom o Transparentnosti u Opštini Južna Mitrovica i Projekt –Akcionog Plana za Opštinsku Transparentnost 2025-2029, možete posetiti sledeće linkove:

- Službene stranice: https://mitroviceejugut.rks-gov.net
- Platforma Javnih Konsultacija: https://konsultimet.rks-gov.net
- Facebook: https://www.facebook.com/MitroviceJugut

**Predsedavajuća Radne Grupe**

**Blerina Kastrati Idrizi**

**Kryetari i Komunës**
**Nr.** 01-020/04-0027010/25 **dt.** 08.05.2025
**Mitrovicë**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 42 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, Kërkesat Elektronike të datës 02.05.2025 dhe datës 07.05.2025 nga znj. Blerina Kastrati Idrizi - Shefe e Zyrës për Informim, dhe Kërkesën Elektronike të datës 06.05.2025 nga z. Valon Hetemi - Shef i Kabinetit të Kryetarit, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

## VENDIM

**(Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Rregullores për Transparencë dhe Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut)**

1. **Formohet** Grupi Punues për Hartimin e Rregullores për Transparencë dhe Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:

   **1.1.** Blerina Kastrati Idrizi – Kryetare, (Zyra për Informim);
   **1.2.** Korab Prekazi – anëtar, (Zyra e Kryetarit);
   **1.3.** Artan Xhaka – anëtar, (Zyra për Teknologji Informative);
   **1.4.** Zenel Çitaku – anëtar, (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
   **1.5.** Mentor Ujkani – anëtar, (Drejtoria për Buxhet dhe Financa);
   **1.6.** Merita Preteni – anëtare, (Sekretaria e Kuvendit);
   **1.7.** Teuta Selmani Pllana – anëtare, (Zyra Ligjore);
   **1.8.** Kushtrim Mehaj – anëtar, (Zyra e Prokurimit);
   **1.9.** Besa Veseli – anëtare, (Zyrtare për Barazi Gjinore);
   **1.10.** Sebahate Tahiri – anëtare, (Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm);
   **1.11.** Bardha Haxhiu – anëtare, (Përfaqësuese e OJQ-ve).

2. Grupi punues është përgjegjës për Hartim të Draft - Rregullores për Transparencë dhe Draft - Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

3. Pas Hartimit të Draft – Rregullores për Transparencë dhe Draft – Planit të Veprimit për Transparencë Komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, të njëjtat të procedohen për votim në Kuvendin e Komunës, përmes Kryetarit të Komunës.

4. Grupi Punues i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Mandati i Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

**Shtojcë:**

1x1 Kërkesat Elektronike të dt. 02.05.2025, dhe dt. 07.05.2025 nga znj. Blerina Kastrati Idrizi – Shefe e Zyrës për Informim;
1x1 Kërkesa Elektronike e dt. 06.05.2025 nga z. Valon Hetemi - Shef i Kabinetit të Kryetarit.

**T'i dërgohet:**

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Anëtarëve Grupit Punues
1x1 Arkivit